

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"TULLA NOUVELLE " SH.P.K.**

**TITULLI I
THEMELIMI, EMËRTIMI, SELIA DHE KOHËZGJATJA**

NENI 1 – THEMELIMI DHE EMËRTIMI


Nëpërmjet këtij akti të krijuar sot më datë 12/06/2018 u paraqitën personalisht ortakët themelues për krijimin e një shoqërie si më poshtë vijon:

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "**TULLA NOUVELLE**" SH.P.K. Kjo shoqëri themelohet sot, në datë 12/06/2018, sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe ndryshimeve të saj.

Kjo shoqëri krijohet nga ortakët themelues:

1. **SOFOKLI ÇALI** biri i Dhimitraq-it dhe i Elida-së, i datëlindjes 23.02.1985, vendlindja Lushnje, dhe vendbanimi Himarë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me numër 032916917 dhe numër personal I50223053J
2. **PANO VASILI** biri i Maksim-it dhe i Amali-së, i datëlindjes 05.08.1982, vendlindja Himarë, dhe vendbanimi Himarë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me numër 030319504 dhe numër personal I20805044E.
3. **ALBAN NIMANI** biri i Shyqyri-ut dhe i Samile-es, i datëlindjes 13.06.1977, vendlindja Prishtinë, dhe vendbanimi Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga pasaporta me numër BG6021561 dhe numër personal H70613222B
4. **RUBIN BEQO** biri i Atdhe-ut dhe Dallëndyshe-s, i datëlindjes 13.02.1985, vendlindja Tiranë, dhe vendbanimi Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga pasaporta me numër BC0198018 dhe numër personal I50213047H

Ortakët themelues të lartpërmendur vendos shprehimisht krijimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "**TULLA NOUVELLE**" SH.P.K.



NENI 2 – KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është me një afat të papërcaktuar. Kjo shoqëri mund të përcaktojë, zgjasë ose të zvogëlojë afatin me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve, një ose disa herë.

NENI 3 – SELIA

Shoqëria ka selinë e saj ligjore në Tiranë, Tarraca Pallati i Kulturës, Sheshi Skënderbej Tiranë, në pasurinë numër: 1/4 – N3 me çertifikatë pronësie nr. 259632. Ajo mund të hapë seli dytësore, degë dhe përfaqësi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 4 – VENDBANIMI I ORTAKËVE

Vendbanimi ligjor i ortakëve për çdo dhe çfarëdo raporti me Shoqërinë, është ai që rezulton në librin e ortakëve.

TITULLI II

OBJEKTI, KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

NENI 5 – OBJEKTI


Shoqëria ka si objekt kryesor:

Organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme social kulturore si koncerte, kinema, teatër, festivale. Kryerje shërbimesh për pije dhe ushqim në funksion të këtyre veprimtarive.

NENI 6 – KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 4 kuota të zotëruara nga ortakët e shoqërisë si më poshtë:

1. Kuotë e cila përbën 25% (Njëzet e pesë përqind) ose në vlerë nominale 25.000 lekë të kapitalit të zotëruara nga z. **SOFOKLI ÇALI**
2. Kuotë e cila përbën 25% (Njëzet e pesë përqind) ose në vlerë nominale 25.000 lekë të kapitalit të zotëruara nga z. **PANO VASILI**
3. Kuotë e cila përbën 25% (Njëzet e pesë përqind) ose në vlerë nominale 25.000 lekë të kapitalit të zotëruara nga z. **ALBAN NIMANI**
4. Kuotë e cila përbën 25% (Njëzet e pesë përqind) ose në vlerë nominale 25.000 lekë të kapitalit të zotëruara nga z. **RUBIN BEQO**



Kuotat janë të transferueshme. Transferimi i kuotave nga ortakët në favor të të tretëve bëhet gjithmonë me aprovimin unanimit të ortakëve me anë të aktit noterial.

Në rast se njëri nga ortakët do të shesë pjesën e tij të kapitalit duhet të respektojë të drejtën e parablerjes së ortakut tjetër.

Të gjitha veprimet e shoqërisë mbi kapitalin bëhen vetëm me aprovimin e ortakëve.

TITULLI III ADMINISTRIMI DHE REGJISTRIMI

NENI 7 – ADMINISTRIMI

1. Shoqëria do të ketë Administrator të saj z. **SOFOKLI ÇALI** biri Dhimitraq-it dhe i Elida-së, i datëlindjes 23.02.1985, vendlindja Lushnje, dhe vendbanimi Himarë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar nga karta e identitetit me numër 032916917 dhe numër personal I50223053J për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

NENI 8 – REGJISTRIMI

Fillimin e aktivitetit të saj tregtar kjo shoqëri e lidh me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Për sa nuk është folur shprehimisht në AKTIN E THEMELIMIT, do të pasqyrohet hollësisht në dispozitat e STATUTIT.

NENI 9 - TË TJERA


Në rast mosmarrëveshje ndërmjet ortakeve dhe nuk ka mirëkuptim ndërmjet palëve, për zgjidhjen e tyre, kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES


1. **SOFOKLI ÇALI**

Sofokli Çali 

3. **ALBAN NIMANI**

Alban Nimani 

2. **PANO VASILI**

Pano Vasili 

4. **RUBIN BEQO**

Rubin Beqo 